

FDH-33268; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

### **Rrustem (Murtez) Hysenaj**

(25.02.1925, shqiptar nga Obria e Epërme/ Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, bujk, shtatë fëmijë)

### **Ali (Hisen) Kalludra**

(15.10.1931, shqiptar nga Gremniku/Grebnik, komuna e Klinës/Klina, kuzhnier, tetë fëmijë)

### **Hyrë (Cene Kelmendi) Kalludra**

(1.09.1947, shqiptare nga Gremniku/Grebnik, komuna e Klinës/Klina, tetë fëmijë)

Aliu me bashkëshorten Hyrën, si dhe djali i tij, Shabani, me bashkëshorten dhe fëmijët e vet, e braktisën Gremnikun/Grebnik [Klinë/Klina] në verë të vitit 1998, ngase forcat serbe e sulmuan fshatin. Qëndruan në Sverkë/Svrhe për një kohë të shkurtër. Pastaj, kaluan në Siqevë/Sićevo dhe, më vonë, në Aqarevë/Ovčarevo. Duke kërkuar strehim më të sigurt, në fund shkuan në **Obrinë e Epërme/Gornje Obrinje**, ku në shtëpinë e vet i pranoi miku i tyre, Rrustem Hysenaj. Nga mesi i muajit shtator të vitit 1998, Shabani me familje shkoi në Malin e Zi, ndërkaq prindërit e tij kanë mbetur te Rrustemi dhe bashkëshortja e tij Shehidja. Në datën **26.09.1998**, që të gjithë ata e braktisën shtëpinë dhe u fshehën në lagjen e tyre, afro 100 metra larg nga shtëpia, sepse në fshat kishin depërtuar forcat serbe. Në mbrëmje, Rrustemi vendosi të kthehej në shtëpi për të parë nëse çdo gjë ishte në rregull. Nuk u kthye më. Ditën tjetër, më **27.09.1998**, Shehidja u nis për të parë çfarë kishte ndodhur me Rrustemin. Në të njëjtën kohë, aty pranë ia bëhen policët serb. I morën me vete Aliun dhe Hyrën dhe i çuan në shtëpinë e Nasuf Hysenajt. Më pas, atje e çuan edhe Shehidën, e cila aty i takoi edhe katër fëmijë të familjes Deliu [të shikohet regjistrimi i mëparshëm]. Nuk kaloi shumë kohë dhe policët e nxorën Hyrën jashtë dhe e therën me thikë në fytyrë. Pas afro 20 minutash, e morën jashtë edhe Aliun dhe e ekzekutuan me sëpata. Shehidën e liruan që të largohej me fëmijët. Kur u kthye në shtëpi, në oborr e gjeti trupin e pajetë të

Rrustemit. Aliu, Hyra dhe Rrustemi u varrosën në varrezat në Obri të Epërme/ Gornje Obrinje më 30.09.1998. Në maj të vitit 2000, Shabani i ka rivarrosur mbetjet mortore të prindërve të vet në fshatin e lindjes në Gremnik/Grebnik.

**Burimet:** deklarata S.K, FDH-16483; deklarata S.H, FDH-16524; deklarata I.D, FDH-33503; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 114, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

### **Sherif (Rrustem) Deliu**

(10.10.1931, shqiptar nga Obria e Epërme/ Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtime, pesë fëmijë)

Në datën **26.09.1998**, kur forcat serbe depërtuan në fshatin e **Obrisë së Epërme/ Gornje Obrinje**, Sherifi me familjarët Fitimin dhe Azemin ishin fshehur të varrezat në *Mëhallën Hajdaraj*. Një predhë e forcave serbe ka rënë afër tyre dhe nga eksplozimi i saj u plagosën Sherifi dhe Azemi. Fitimi i çoi që të dy në shtëpinë e Muharem Hisenajt. Pas pak, Sherifi u nis për të kërkuar ndihmë. Nuk u kthye më. Fati i tij nuk ishte i njohur deri më 29.03.1999, kur kufoma e tij u zbulua në *Zabelin e Hysenit/Hysenov šumarak*. Po atë ditë, u varros në fushë që ishte në pronë të djalit të axhës, Imer Deliu. Pas mbarimit të luftës, më 26.09.1999, mbetjet mortore të Sherifit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Obri të Epërme/ Gornje Obrinje.

**Burimet:** deklarata I.D, FDH-8886; deklarata R.D, FDH-8882; deklarata I.D, FDH-16499; deklarata M.A, FDH-8880; deklarata I.D, FDH-33503; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

### **Hajriz (Fazli) Deliu**

(14.04.1964, shqiptar nga Obria e Epërme/ Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, pensionist, dy fëmijë)

Hajrizi jetonte me bashkëshorten Zahiden dhe vajzat Donjeten dhe Gentijanën [të shikohet regjistrimi]. E afërmja e tij, Zoja Deliu, ishte personi i fundit që e shihte atë